

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.28.01.2025*

**Data 28.01.2025
Ora 10:15**

RENDI I DITËS

Për shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin nr. 1, datë 13.01.2025, të regjistrit të denoncimeve të organizatës “Qëndresa qytetare”.

PJESËMARRJA:

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Znj. P. Doçaj, znj. J. Josifi**
- **Parti Politike:** **S’ka prezent!**
- **OJQ:** **KRIIK**

Znj. P. Doçaj: Pika e tretë e rendit të ditës ka të bëjë me shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin nr. 1, datë 13.01.2025, të regjistruar nga organizata “Qëndresa qytetare”. Pas shqyrtimit administrativ dhe seancës dëgjimore ku u dëgjuan edhe pretendimet e palëve, nga hetimi administrativ i kryer nga KQZ-ja pasi dërguam monitorues për të konstatuar në vend se ku është zhvilluar aktiviteti objekt i këtij denoncimi, ka rezultuar se aktiviteti është zhvilluar në ambientet e qendrës kulturore, sikurse është provuar edhe nga fotot që ia janë bashkëlidhur raportit të monitoruesit. U raportua se kjo qendër kulturore përdoret për shumë aktivitete dhe u vërtetua se ata që e kanë zhvilluar kanë marrë leje për të zhvilluar këtë aktivitet. Për sa më sipër, vlerësoj se jemi në kushtet kur duhet të pushohet hetimi administrativ nga Bashkisë Kamëz.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.28.01.2025*

Z. I. Celibashi: Dakord për të vendosur në këtë mënyrë dhe do të duhet që këtë qëndrim të mbajmë në vijim për ato objekte, të cilat nuk janë shkolla apo biblioteka apo ambiente të kësaj natyre, kur janë pallate kulture ose salla, normal që mund të zhvillohen edhe aktivitete me karakter politik.

Vendimi nr. __

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.28.01.2025*

**Data 28.01.2025
Ora 10:12**

RENDI I DITËS

**Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik për periudhën
19 janar – 25 janar 2025.**

PJESËMARRJA:

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Staf i KQZ: **Znj. P. Doçaj, Znj. J. Josifi**
- **Parti Politike:** **S'ka prezent!**
- **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëmëngjesi! Në seancën e sotme në rendin e ditës janë çështjet: për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik për periudhën 19 janar – 25 janar 2025 të institucioneve publike; për shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Cërrrik për periudhën 11 janar – 18 janar 2025”; për shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin nr. 1, të organizatës “Qëndresa qytetare”; projektvendimi që i ka të bëjë me miratimin e modeleve të një pjese të dokumentacionit zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë për procesin zgjedhor të votimit nga jashtë vendit; projektvendim “Mbi përdorimin në procesin zgjedhor të disa materialeve dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim për procesin e votimit nga jashtë vendit”; projektvendim “Për caktimin e njësisë administrative ku

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.28.01.2025*

do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”; projektvendim “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve; projektvendime për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Sarandë dhe në Këshillin e Bashkisë Tiranë.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Znj. P. Doçaj: Pika e parë e rendit të ditës ka të bëjë me vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik për periudhën 19 janar-25 janar. Në lidhje me këtë periudhë konstatojmë që 70 institucione të reja janë regjistruar në ndërfaqen elektronike NRI, 357 raportime janë kryer në total, 334 janë postime aktive dhe 23 janë veprime të ndaluara. Për këtë periudhë në ndërfaqen e raportimeve janë ndaluar 23 veprimtari, nga të cilat 13 institucione për shkak të tejkalimit të afatit ligjor dhe 1 institucion për shkak të tematikës së veprimtarisë. Pra, në total janë 14 institucione, për të cilat propozojmë fillimin e procedimit administrativ.

Z. I. Celibashi: Dakord.

Vendimi nr. 42

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.28.01.2025*

**Data 28.01.2025
Ora 10:14**

RENDI I DITËS

**Për shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të
Bashkisë Cërrik për periudhën 11 janar – 18 janar 2025”.**

PJESËMARRJA:

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Znj. P. Doçaj, Znj. J. Josifi**
- **Parti Politike:** **S’ka prezent!**
- **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

Znj. P. Doçaj: Pika e dytë e rendit të ditës ka të bëjë me shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Cërrik për periudhën 11 janar – 18 janar 2025”, me subjekt Bashkinë Cërrik, me objekt shqyrtimin administrativ të këtyre veprimtarive publike të Bashkisë Cërrik. Është bërë seanca publike, janë ftuar palët dhe është konstatuar e vërtetuar se kjo veprimtari nuk është organizuar nga Bashkia Cërrik. Ftesa ka qenë për të marrë pjesë në një aktivitet politik kryetari i bashkisë, Andis Salla. Rezultoi që ky aktivitet të jetë publikuar në faqen e *facebook*-ut personal të zotit Andis Salla dhe për këtë arsye ne propozojmë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.28.01.2025*

pushimin e hetimit administrativ, pasi publikimi i këtyre fotove të aktivitetit politik ka qenë në faqen personale të kryetarit të bashkisë, zoti Andis Salla.

Z. I. Celibashi: Dakord. Në këto rrethana do të bëjmë pushimin e hetimit administrativ dhe besoj se herën e shkuar ia bëmë të qartë përfaqësuesit të Bashkisë Cërrrik në lidhje me dallimin që duhet të ketë ndërmjet aktivitetit politik dhe atij për shkak të detyrës dhe mënyrës së pasqyrimit të tyre.

Vendimi nr. 43

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.28.01.2025*

**Data 28.01.2025
Ora 10:17**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Mbi miratimin e modeleve të një pjese të dokumentacionit zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë për procesin zgjedhor të votimit nga jashtë vendit”.

PJESËMARRJA:

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Znj. P. Doçaj, Znj. J. Josifi**
- **Parti Politike:** **S’ka prezent!**
- **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë të pika e katërt që ka të bëjë me miratimin e disa modeleve të dokumenteve zgjedhore, që do të përdoren për procesin zgjedhor të votimit nga jashtë.

Znj. J. Josifi: Faleminderit! Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “n”, dhe 2 të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohen kompetencat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe në zbatim të nenit 24, pika 1, nenit 25, nenit 99 e vijues të Kodit Zgjedhor, por edhe vendimit nr. 13, datë 12.11.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave për procedurën e votimit nga jashtë vendit”, në kreun III, nënkreu III.I, me titull “Rregulla të posaçme”, ku parashikohet dokumentacioni

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.28.01.2025*

zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë vendit, ku përfshihet: fleta e votimit, zarfi ku futet fleta e votimit, materiali udhëzues që përmban sqarime për zgjedhësin për plotësimin e fletës së votimit, si dhe procedurat e dërgimit mbrapsht të fletës së votimit nga zgjedhësi në KQZ, zarfi i jashtëm ku vendoset zarfi që përmban fletën e votimit. Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për ta shqyrtuar atë. Projektvendimi është hartuar në mbështetje të ndryshimeve më të fundit të Kodit Zgjedhor, me qëllim përcaktimin e rregullave për përdorimin e një pjese të dokumentacionit zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë, si dhe karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim në procesin e votimit nga jashtë vendit. Në lidhjet 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij projektvendimi renditet ky dokumentacion, përdorueshmëria, si dhe karakteristikat e përgjithshme dhe të veçanta të tyre duke dhënë dy modelet përkatëse. Projektvendimi liston si pjesë të dokumentacionit zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë zarfin ku futet fleta e votimit, i cili është në përmasa dhe në ngjyrë të njëjtë për të gjithë zgjedhësit. Zarfi ku futet fleta e votimit është zarfi i brendshëm, i cili përmban vetëm fletën e votimit dhe vendoset në zarfin e jashtëm të dërguar tek zgjedhësi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sipas parashikimeve të kreut III.1 të vendimit nr. 13/2024 të Komisionit Rregullator. Mbi këtë zarf, ky është quajtur zarfi i jashtëm, KQZ-ja do të vendosë/ngjisë Kodin Unik të çdo zgjedhësi në PER. Ky kod do të gjenerohet automatikisht nga platforma dhe përmban emër, mbiemër të zgjedhësit, shtetin ku ky i fundit ka kërkuar t'i dërgohet fleta e votimit, si dhe qarkun ku është regjistruar në gjendjen civile në Republikën e Shqipërisë. Kodi Unik i zgjedhësit është gjithashtu i pasqyruar në formën e një *QR Code*. Në momentin që zgjedhësit i mbërrin në adresën e deklaruar nga jashtë vendit zarfi i dërguar nga KQZ, zgjedhësi do të konfirmojë në PER marrjen në dorëzim të zarfit. Sa i përket zarfit të jashtëm,

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.28.01.2025*

është zarfi mbi të cilin është vendosur Kodi Unik dhe në brendësi do të ketë zarfin që mban fletën e votimit. Ky zarf i jashtëm futet në zarfin e operatorit të shërbimit postar dhe postohet nga zgjedhësit për në adresën e KQZ-së. Lidhjet 1 dhe 2, praktikisht zarfi i fletës së votimit, por edhe zarfi i jashtëm jepen në monitor. Zarfi i jashtëm, që është quajtur zarfi B, përveç elementeve identifikuese, stemës së Republikës, logos së KQZ-së, ka në fund të tij kodin unik të zgjedhësit, që, siç e thashë, do të ketë këto të dhëna të përcaktuara tashmë në vendimin e Komisionit Rregullator. Zarfi i fletës së votimit ose zarfi i brendshëm ose zarfi i vogël, siç e quajmë, është zarfi A në lidhjen përkatëse të këtij projektvendimi. Në këtë zarf janë vënë shënimet udhëzuese për zgjedhësin se në të ndalohej çfarëdolloj shënimi, pra zgjedhësi në këtë zarf thjesht do të duhet ta palosë fletën e votimit, duhet ta vendosë atë brenda. Pasi ka plotësuar fletën e votimit, në anën e pasme të zarfit i thuhet përkatësisht që ta fusë fletën e votimit brenda këtij zarfi e më pas këtë zarf ta mbyllë. Nuk do të duhet të bëhet asnjë lloj shënimi mbi këtë zarf.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, në respektim të detyrimeve e afateve ligjore, i propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Mbi miratimin e modeleve të një pjese të dokumentacionit zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë për procesin zgjedhor të votimit nga jashtë vendit”. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Domethënë ne e kemi të indeksuar me germa zarfin e fletës së votimit dhe zarfin e jashtëm. A-ja është zarfi i fletës së votimit dhe ky indeksimi shënohet në të dyja anët e zarfit, edhe për zarfin e fletës së votimit, edhe për zarfin e jashtëm. Kështu është.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.28.01.2025*

Z. J. Josifi: Po, zarfi i parë është edhe më i madh e nuk u dallua në monitor, por e ka shënimin, ai është zarfi B. Edhe ky e ka nga të dyja anët shënimin, pra këtë kodin, që është thjesht një emërtim, i cili do të na shërbejë për materialin udhëzues që do t'i dërgohet zgjedhësit, pra, për ta dalluar, për t'i dhënë ato udhëzimet, shikoni në zarfin A do të duhet të fusni fletën, në zarfin B do të duhet të fusni zarfin A, e cili ka brenda fletën. Është thjesht për lehtësi udhëzimi.

Z. I. Celibashi: Dakord. U është dërguar partive politike, organizatave, nuk kemi pasur *feedback* nga asnjë prej të interesuarve.

Z. J. Josifi: Jo, nuk kemi pasur. U është dërguar.

Z. I. Celibashi: Dakord. E miratojmë sipas draftit të propozuar projektaktin së bashku me modelet përkatëse.

Vendimi nr. 45

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.28.01.2025*

**Data 28.01.2025
Ora 10:23**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Mbi përdorimin në procesin zgjedhor të disa materialeve dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim për procesin e votimit nga jashtë vendit”.

PJESËMARRJA:

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Znj. P. Doçaj, Znj. J. Josifi**
- **Parti Politike:** **S’ka prezent!**
- **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës mbi përdorimin në procesin zgjedhor të disa materialeve dhe karakteristikat e tyre të përgjithshme.

Z. J. Josifi: Për projektvendimin “Mbi përdorimin në procesin zgjedhor të disa materialeve dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim për procesin e votimit nga jashtë vendit” vijon të jetë e njëjta bazë ligjore neni 19, pika 1, shkronja “n”, dhe 2 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, neni 24, neni 25, neni 99 e vijues, si dhe vendimi nr. 13/2024 të Komisionit Rregullator. Nga pikëpamja e objektit vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për ta shqyrtuar këtë projektvendim. Ky projektvendim

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.28.01.2025*

është hartuar në mbështetje të ndryshimeve më të fundit të Kodit Zgjedhor me qëllim mundësimin e procesit të votimit nga jashtë vendit. Në lidhjen 1 bashkëlidhur këtij projektvendimi renditen materialet zgjedhore, përdorueshmëria e tyre, si dhe disa karakteristika të përgjithshme dhe të veçanta të tyre. Në këtë projektvendim listohet materiali zgjedhor, vulat me kod sigurie, të cilat shërbejnë për vulosjen e të gjitha kutive të votimit nga jashtë dhe të materialeve zgjedhore përgjatë procesit zgjedhor dhe verifikimit paszgjedhor, si edhe kutitë e votimit. Vulat me Kod Sigurie si karakteristika të përgjithshme për analogji edhe me ato të përdorura në administrimin e procesit zgjedhor brenda vendit, do të duhet të kenë rezistencën, të jenë të testuara për një forcë thyerje, tërheqje, përkulje dhe të jenë sipas disa standardeve. Në projektvendim listohen gjithashtu si material zgjedhor kutitë e votimit, të cilat do të përdoren për të mundësuar depozitimin e dokumentacionit zgjedhor të zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit për subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në procesin zgjedhor, veçmas për çdo qark. Kutitë e votimit ku do të hidhet materiali zgjedhor i zgjedhësve nga jashtë vendit për t'u ruajtur deri në momentin e fillimit të numërimit e vlerësimit të votave, janë të njëjta, por në varësi të përdorimit kryejnë 4 funksionalitete: ato janë të përcaktuara si lloje kutish në vendimin nr. 13 të Komisionit Rregullator, përkatësisht: kutia e votimit nga jashtë vendit; kutia rezervë e votimit nga jashtë vendit; kutia e posaçme e votimit nga jashtë vendit dhe kutia rezervë e posaçme e votimit nga jashtë vendit. Këto kuti, që për hir të këtij projektvendimi, ne i kemi quajtur kutitë e votimit nga jashtë, pra të katërta llojet, si karakteristika të përgjithshme kanë këto elemente: të jenë të palosshme, të hapura vetëm nga një anë, në të cilën vendoset kapaku përkatës dhe nëpërmjet të cilit mundësohet hedhja e dokumentacionit zgjedhor në këtë rast, jo thjesht e fletës së votimit, duhet të jenë të tejdukshme nga të paktën katër anët, të kenë aftësi për të mbajtur ngarkesa të brendshme pa u deformuar.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.01.2025*

Znj. J. Josifi: Pjesa e sipërme e kutive (kapaku) të jetë e qëndrueshme ndaj presionit të jashtëm. Kutitë e votimit nga jashtë duhet të mbyllet me kapak, i cili lidhet me kutinë me 4 vula me kode sigurie. Kapaku duhet të ketë një të çarë nëpërmjet të cilës mund të futet dokumentacioni zgjedhor, por njëkohësisht e njëjta e çarë nuk duhet të lejojë nxjerrjen e këtij dokumentacioni dhe do të duhet të mundësojë funksionalitetin e mbylljes me vulë me kod sigurie edhe e çara e kapakut të sipërm. Karakteristika të veçanta për kutitë e votimit nga jashtë, në këtë projektvendim janë përcaktuar: kapaciteti mbajtës i kutive të votimit nga jashtë, që në ndryshim nga ai i kutive brenda vendit, është parashikuar të jetë më i madh, për arsye të thjeshtë se në rastin e kutive brenda vendit aty futet vetëm fleta e votimit, në këtë rast futet seti i dokumentacionit zgjedhor që mbërrin në KQZ. Në këtë kuptim kapaciteti mbajtës do të duhet të jetë të paktën 100 litra, afërsisht e barabartë me kapacitetin e 1.000 dokumentacioneve zgjedhore, me përmasa (A3), të palosura dhe të jenë me transparencë të lartë për të vëzhguar lehtësisht mostjetërsueshmërinë e votës. Forma e e kutive duhet të jetë prizëm gjysmë piramide me lartësi të brendshme 60 cm (+/- 2 cm). Kapaku i kutive të votimit nga jashtë duhet të ketë hapësirën e posaçme ku futet dokumentacioni zgjedhor nga jashtë, si dhe të ketë dimensione që përputhen me kutitë e votimit nga jashtë dhe të mbyllet pa krijuar hapësira me buzët e kutive të votimit nga jashtë, pra të mos mund të krijojë hapësirë për të futur apo për të nxjerrë dokumentacion zgjedhor. Pjesa e hapur e kapakut nëpërmjet të cilës hidhet dokumentacioni zgjedhor në kuti do të duhet të mbyllet me të paktën një vulë sigurie në përfundim të procesit të votimit, pra sipas momentit dhe modalitetit të mbylljes së secilës prej katër llojeve të kutive, siç është përcaktuar në vendimin 13 të Komisionit Rregullator. Ndërkohë në projektvendim është renditur si material zgjedhor, janë renditur edhe etiketat e sigurisë, që shërbejnë për vulosjen dhe matrikulimin e materialeve apo ambienteve të ndryshme zgjedhore gjatë të gjitha

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.01.2025*

proceseve të punës. Për sa më lart, në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore i propozohet për shqyrtim dhe miratim ky projektvendim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Ky projektakt është dërguar për konsultim partive dhe organizatave dhe nuk kemi pasur mendime apo propozime. Mirë e miratojmë sipas draftit të propozuar projektaktin.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.01.2025*

28.01.2025

Ora 10:29

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** **Z. E. Meta, znj. P. Doçaj, znj. J. Josifi, znj. L. Veliu**

Parti Politike:

Të tjerë: **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën 6 të rendit të ditës, “Për caktimin e njësive administrative ku do të vendosen selitë e KZAZ-ve”. Po Erion.

Z. E. Meta: Në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 93 të Kodit Zgjedhor, duhen krijuar selitë e KZAZ-ve, sipas kushteve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni. Eksperienca e zgjedhjeve të vitit 2023 dëshmuon se krijimi i selive të KZAZ-ve në njësitë administrative me vendndodhje gjeografike në Zonat e Administrimit Zgjedhor, siguruan lehtësi logjistike të transportit rrugor, baraslarguar nga qendrat e votimit në juridiksionit territorial të ZAZ-ve, dhe në afërsi me ambientet të cilat u përzgjedhën për caktimin e VNV-ve. Ky vendim është hartuar duke u mbështetur në përvojën e zgjedhjeve të vitit 2023, ku është vlerësuar se selitë e vendosura në pozicione të përshtatshme gjeografike kanë lehtësuar organizimin dhe transportin e bazës materiale. Në krahasim me vendodhjen e selive të KZAZ-ve

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.01.2025*

në zgjedhjet e 2023 vërehen së për KZAZ-të e Qarkut Lezhë, dy KZAZ kanë ndryshime të selisë, përkatësisht Bashkia e Kurbinit dhe një KZAZ në Bashkinë Lezhë. Për KZAZ-në e Qarkut Durrës ka një ndryshim të vendndodhjes së KZAZ-së 25 nga shkolla “Leonik Tomeo” është vendosur te shkolla e mesme e përgjithshme “Naim Frashëri”. Për KZAZ-të e qarkut Tiranë, vetëm KZAZ 40 ka ndryshim të selisë me atë të vitit pararendës, pra të vitit 2023, nga Muzeu Historik Kombëtar (që është në fazë rikostruksioni) është vendosur në shkollën e mesme të përgjithshme “Sami Frashëri”. Për KZAZ-të e qarkut Elbasan, vendndodhja e selive nuk ka ndryshuar me ato të zgjedhjeve të vitit zgjedhor 2023, përveç Bashkisë Cërrrik që ka një ndryshim vetëm në emërtesë dhe Bashkisë Peqin e cila nga inspektimi i bërë nga Drejtoria e Administratës Zgjedhore rezultoi që ishte i papërshtatshëm dhe është në proces rikonstruksioni dhe u propozua në një shkollë. Për bashkitë e tjera të qarkut Korçë, Shkodër, Kukës, Dibër, Fier, Berat, Gjirokastrë selitë do të jenë me të njëjtat me ato të vitit zgjedhor 2023. Projektvendimi është konsultuar me organizata të shoqërisë civile dhe partitë politike. Organizata KRIIK ka kërkuar që për KZAZ-të 1 dhe 17 të ketë një mirëpërcaktim të adresës, e cila është reflektuar në projektvendimin e paraqitur, ndërsa nga partitë politike nuk ka pasur asnjë pretendim. Bashkëlidhur projektvendimi për shqyrtim dhe miratim.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëherë miratojmë vendndodhjen sipas draftit të propozuar, pra vendodhjen e selive të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor.

Vendim nr.44

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.01.2025*

28.01.2025

Ora 10:32

RENDI I DITËS

Projektvendimin “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”. (Për caktimin e anëtarit të 7, do të organizohet shorti).

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Z. E. Meta, znj. P. Doçaj, znj. J. Josifi, znj. L. Veliu
Parti Politike: Nuk ka prezent
Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën 7 të rendit të ditës, që ka të bëjë me caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet e datës 11 maj 2025.

Z. E. Meta: Në zbatim të nenit 28 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka për detyrë të përcaktojë partitë politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, KZAZ-të për zgjedhjet e datës 11 maj 2025. Ky përcaktim bazohet në numrin e mandateve të fituara nga partitë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe në përkatësinë e tyre si shumicë apo opozitë parlamentare. Neni 29, pika 4, fjalia e dytë e Kodit Zgjedhor përcakton qartë procedurën që ndiqet për caktimin e partive që kanë të drejtën të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.01.2025*

propozojnë anëtarët e KZAZ-së. Në zgjedhjet për Kuvend, renditja përcaktohet mbi bazën e numrit të mandateve të fituara në shkallë vendi për zgjedhjet pararendëse për Kuvend nga partitë parlamentare. Pra, që një parti të gëzojë të drejtën për të propozuar kandidatë në KZAZ duhet të plotësojë dy kushte: së pari të ketë marrë pjesë në zgjedhjet pararendëse në Kuvend dhe së dyti të jetë parti parlamentare. Dy anëtarë të KZAZ-së i propozon partia kryesore e shumicës parlamentare, e cila ka numrin më të madh të mandateve në shkallë vendi për zgjedhjet në Kuvend. Brenda konfigurimit të shumicës parlamentare sipas rezultatit të zgjedhjeve të datës 25 prill 2021. Një anëtar të KZAZ-së e propozon partia e dytë e shumicës parlamentare, e cila ka numrin më të madh të mandateve në shkallë vendi për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021, pas partisë kryesore të shumicës. Dy anëtarë të KZAZ-së i propozon partia kryesore e opozitës parlamentare, e cila ka marrë numrin më të madh të mandateve në shkallë vendi për Kuvend brenda konfigurimit të pakicës parlamentare sipas rezultatit të zgjedhjeve të datës 25 prill 2021. Një anëtar të KZAZ-së e propozon partia e dytë e opozitës parlamentare, e cila ka marrë numrin më të madh të mandateve në shkallë vendi në Kuvend për zgjedhjet e datës 25 prill 2021, pas partisë kryesore të opozitës. KQZ i është drejtuar Kuvendit të Shqipërisë me datën 17 dhjetor 2024, duke kërkuar informacion mbi konfigurimin, shumicën opozitë të partive parlamentare në nisje të legjislaturës 2021-2025. Përgjigja e Kuvendit në datën 7 janar dhe shkresa pasuese me datën 23 janar ofruan të dhëna mbi qëndrimet e mbajtura nga deputetët gjatë votimeve për çështje kryesore si votëbesimi i qeverisë dhe miratimi i buxheteve të shtetit nga viti 2021 deri në 2025. Nga këto dokumenta u vlerësua se “Partia Socialiste e Shqipërisë” rezulton se është partia kryesore e shumicës parlamentare me 74 mandate. Partia Socialdemokrate me 3 mandate konsiderohet gjithashtu parti i dytë e shumicës parlamentare, për shkak të qëndrimeve të vazhdueshme pro qeverisë në votimet kryesore. Partia Demokratike

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.01.2025*

me 50 mandate është partia kryesore pro opozitës parlamentare dhe Partia e Lirisë, ose ish Lëvizja Socialiste për Integrim me 4 mandate është partia e dytë e opozitës parlamentare. Kuvendi ka listuar edhe partitë e tjera parlamentare të cilat kanë një numër më të vogël mandatesh se Partia e Lirisë, e cila renditet si partia e dytë e opozitës parlamentare. Për këtë arsye sipas nenit 29, pika 4 e Kodit Zgjedhor, këto parti aktualisht nuk gëzojnë të drejtën për të propozuar anëtarë të KZAZ-së. Këto parti janë renditur si më poshtë: Partia Republikane me tre mandate, Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet me dy mandate, Partia Agrare Ambientaliste me një mandat, Partia Lëvizja e Legalitetit me një mandat, Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar me një mandat dhe Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut me një mandat. Këto parti kanë të drejtën të propozojnë anëtarët vetëm në rast se partitë me të drejtë propozimi, respektivisht partia e parë dhe e dytë e shumicës së opozitës parlamentare nuk paraqesin propozimet e tyre brenda afatit, të përcaktuar në nenin 29 të Kodit Zgjedhor, konkretisht me datën 10 shkurt 2025. Bazuar në këtë renditje, sipas dispozitës së nenit 29 të Kodit Zgjedhor rezulton se e drejta për propozime për anëtarë të KZAZ-së është si vijon: Partia Socialiste e Shqipërisë si partia kryesore e shumicës parlamentare propozon dy anëtarë të KZAZ-së. Partia Socialdemokrate si partia e dytë e shumicës parlamentare propozon një anëtar. Partia Demokratike si partia kryesore e opozitës parlamentare propozon dy anëtare të KZAZ-ve. Partia e Lirisë, si partia e dytë e opozitës parlamentare propozon një anëtar. Anëtari i shtatë i KZAZ-ve ndahet në mënyrë të barabartë midis Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike, bazuar në procesin e shortit. Shorti realizohet nga KQZ-ja, që do të realizohet në seancë për të përcaktuar se cila parti, PS apo PD do të propozojnë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve, në gjysmën e këtyre komisioneve. Ky proces do të zhvillohet në përputhje me nenin 4 dhe 5 të vendimit nr.5, të vitit 2020 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores së funksionimit të KZAZ-ve”, si vijon: në

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.01.2025*

një enë të parë vendosen goglat me emrat e dy partive, Partia Socialiste dhe Partia Demokratike.

Z. I. Celibashi: Atëherë përpara se të fillojmë me procedurën e shortit, përfundimisht kemi dy anëtarë të propozuar nga Partia Socialiste, si anëtarë të KZAZ-së, si parti kryesore e shumicës parlamentare dhe anëtari i tretë, nga ana e shumicës parlamentare i takon si propozim Partisë Socialdemokrate. Partia Demokratike si parti kryesore e pakicës parlamentare ka dy dhe Partia e Lirisë si partia e dytë e pakicës parlamentare. Me shortin do të ndajmë anëtarin e shtatë, dakord. Po vazhdojmë.

Z. E. Meta: Pra, siç ju shpjegova pak më parë, në një enë vendosen goglat me emrat e dy partive, Partia Socialiste e Shqipërisë dhe gogla e dytë Partia Demokratike. Në një enë të dytë vendosen goglat me mbishkrimin KZAZ me numër tek dhe KZAZ me numër çift. Fillimisht përfaqësuesi i stafit të KQZ do të tërheqë, pasi përzihen, do të për zgjedhë partinë politike, e cila ka të drejtën, Partia Socialiste ka të drejtë të tërheqë në vazon e dytë.

Z. I. Celibashi: Meqenëse s'i kemi përfaqësuesit e partive, kështu që vazhdojmë me Sarën.

Z. E. Meta: Pra Partia Socialiste do të ketë anëtarin e shtatë në KZAZ-të me numër çift, rrjedhimisht Partia Demokratike në ato me numër tek.

Z. I. Celibashi: Ndërkohë sekretari do të propozohet nga Partia Demokratike në KZAZ-të çift dhe në KZAZ-të tek nga Partia Socialiste. Mirë, duke miratuar dhe

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.01.2025*

rezultatit e shortit, miratojmë edhe konfigurimin përfundimtar të KZAZ-ve. Partia Socialiste dy anëtarë, Partia Socialdemokrate një anëtar dhe në KZAZ-të çift, anëtari i shtatë propozohet nga Partia Socialiste. Partia Demokratike do të ketë të drejtën dy anëtarë dhe Partia e Lirisë do të ketë të drejtën të propozojë një anëtar, dhe anëtari i shtatë në KZAZ-të tek, do të jetë propozim i Partisë Demokratike. Mirë, përfundojmë dhe këtë pikë.

Vendimi nr.41

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.01.2025*

28.01.2025

Ora 10:39

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Sarandë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë z.Thanas Pandeli Gurma”.

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë, me kandidatin nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zj. Keda Mirvjen Kaceli”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Stafii KQZ: Z. E. Meta, znj. P. Doçaj, znj. J. Josifi, znj. L. Veliu


Parti Politike: Nuk ka prezent

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Viojmë me pikën tjetër të rendit të ditës. Po Licela.

Znj. L. Veliu: Lidhur me pikën 8, këshilli i bashkisë Sarandë, ka njoftuar KQZ-në për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Erlind Sulo, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Kandidati vijues nga lista shumemërore, është kandidati me numër rendor 12, z. Thanas Pandeli Gurma. KQZ i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e Bashkisë Sarandë, z.Gurma, për të plotësuar dokumentacionin përkatës. Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, ka depozituar formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi i të cilit rezulton se nuk ka

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.01.2025*

deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalim në bazë të ligjit nr. 138/2015. KQZ ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për shtetasin z. Gurma. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar informacion ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Nga informacioni i administruar, kandidati për anëtar z. Gurma në këshillin e Bashkisë Sarandë nuk rezulton në kushtet për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Për sa më lart në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve brenda kompetencave i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi për plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë Sarandë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë z. Thanas Pandeli Gurma.

Këshilli i Bashkisë Tiranë, ka njoftuar KQZ-në për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Arben Tafaj, propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Kandidati vijues nga lista shumemërore, është kandidati me numër rendor 16, znj. Keda Mirvjen Kaceli. KQZ i është drejtuar kandidatit për anëtar, për plotësim dokumentacioni. Kandidati ka plotësuar dhe depozituar formularin e vetëdeklarimit dhe nga verifikimi i të cilit rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që lidhet me parashikimet për ndalim, në ligjin nr. 138/2015. KQZ gjithashtu ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për znj. Keda Kaceli. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka dërguar informacion pranë KQZ-së, ku nga verifikimi i të dhënave konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar informacion pranë KQZ-së, nga verifikimi i të dhënave konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Nga

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.01.2025*

informacionet e administruara për kandidaten për anëtare të këshillit të Bashkisë Tiranë, znj. Keda Kaceli, nuk përbën kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Për sa më sipër, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i paraqesim për shqyrtim dhe miratim projektvendimin për plotësimin e vakancës, me emrin e znj. Keda Kaceli.

Z. I. Celibashi: Dakord, atëherë vendosim plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë Sarandë, me kandidatin nga lista shumemërore të Partisë Socialiste e Shqipërisë, z. Thanas Gurma dhe plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë Tiranë nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, znj. Keda Kaceli. Çështje të tjera nuk kemi. Faleminderit! Seanca mbyllet.

Vendimi nr.39-40

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

